



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 22.01.2024

Projekt-Vendim

Nr. 5 Date. 22.01.2024

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR , PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë, vendimit nr. 597, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, pikës 2, të udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për përfitimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit nga buxheti vendor , për vitin 2024 për bllok-ndihmën ekonomike deri në 3 për qind, si më poshtë:

- Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrimit elektronik për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit ose nga fondi 6%.
- Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
- Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga punonjësi social dhe administratorët shoqëror i njësisë përkatëse
- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
- Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.
- Familje Rome dhe Egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
- Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
- Familje me anëtar në moshë mbi 60-vjet, të cilët kanë në përbërje anëtar mbi moshë pune përfitues të një pensioni pleqërie.
- Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
- Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paafte për të punuar,por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesë P.A.K.

2. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit nga buxheti vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 3 për qind, si më poshtë:
- Njësitë Administrative përpunojnë listën e përfituesve të mundshëm dhe vlerësojnë dosjet për t'u trajtuar me këto fonde.
 - Njësitë Administrative dërgojnë çdo muaj pranë Sektorit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror listën e përfituesve të mundshëm për të përfituar nga ky fond.
 - Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror harton project-vendimin për familjet në nevojë, në bazë të propozimeve të ardhura nga Njësitë Administrative, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi I buxhetit vendor deri në 3 për qind.
3. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit .

Konceptoi:


Përgj. Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror:

(Emër Mbiemër)

A.Lenja

E.Petriti

Nënskrimi



Data

Dt 22.01.2024

Dt 22.01.2024

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

